

Etje Për Ndhmë (pjesa 3 nga 5)
Dua Të Gjej Rrugën e Kthimit Te Perëndia

Përshëndetje, a po e shijoni festimin sot? Jemi në pjesën e tretë të serisë: *“Dua Të Gjej Rrugën e Kthimit Te Perëndia.”*

Ne kemi etje të madhe brenda vetes për dashuri, për qëllim dhe për kuptim në jetë, që mund të ngopet, shuhet vetëm duke patur miqësi me Perëndinë.

Pavarësisht ku je në udhëtimin tënd, ti mund ta gjesh rrugën e kthimit te Perëndia. Ky është qëllimi ynë gjatë gjithë këtij muaji, nëse nuk e ke gjetur rrugën, nëse nuk e ke nisur udhëtimin, ne jemi këtu për të të ndihmuar. Nëse e ke gjetur, jemi këtu për të të forcuar që udhëtimi yt të jetë sa më i lehtë dhe i bukur.

A e di çfarë? Besimi i krishterë mund të zhduket në një brez. Ajo që ka ardhur nga lindja e Krishtit deri më sot, mund të zhduket në një brez, nëse askush nuk i tregon askujt për dashurinë e Perëndisë dhe që Jezusi i deshi aq shumë sa vdiq në kryq për ta. Ashtu siç dikush të tha ty, të ftoi në një festim të tillë, fto edhe ti dikë javës tjetër. Sigurisht nëse të ka pëlqyer ty së pari.

Le të kthehemi te pjesa e 3-të e serisë.

A ke qenë në një situatë ku ke patur shumë nevojë për ndihmën e dikujt? Ishe në një situatë ku nuk po ia dilje dot vetë, ku nuk po i jepje dot drejtim vetë? Një e frikshme, një e sikletshme. (Dëshmi personale (nëse ke))

Cila ka qenë situata jote kur ke ngecur, është bërë një rrëmujë, që ti s'e zgjidhje më dot vetëm? Nganjëherë mund të jetë situatë qesharake. Kur ke qenë fëmijë të ka ngecur dora diku ose koka diku. Mund të ketë qenë një situatë e vështirë dhe e sikletshme,

por ka ca raste që rreziku është më i lartë, saqë bëhet fjalë për jetë a vdekje.

Kush ka patur një nga këto lloj situatash, kur ti kishe ngecur dhe s'po i jepje dot zgjidhje situatës, ku ishte pa ndihmën e dikujt?

Jemi mes serisë 5 - javëshe, kemi folur për etjet ndryshme në udhëtimin tonë: Dua Të Gjej Rrugën e Kthimit Te Perëndia.

1-Javën e parë folëm: Etje për më shumë, duhet të ketë më shumë dhe nëse këto etje nuk i shuajmë te Perëndia do të vijmë vërdallë e do të rraskapitemi kot, sepse janë etje që ngopen, shuhen vetëm kur krijojmë, kemi një marrëdhënie me Perëndinë. Por, herë pas here si djali plangprishës, te historia jonë, ne çohemi dhe ikim për kërkuar vende të tjera për të ngopur këto etje, herë pas here do të zhgenjehemi.

2-Ky lloj zhgënjimi na çon te etja e dytë për të cilën folëm javën e shkuar, Etje për t'ia filluar edhe një herë nga e para. Kur jemi në këtë fazë mund të ngecim në ciklin e keqardhjes. Shkojmë nga drejtimi që kishim, për te cikli i keqardhjes, ndjejmë faj, na vjen keq për veten, për situatën ku jemi. Por nuk po dalim dot, nuk po ecim dot përpara, na vjen keq dhe kaq.

Për dikë, cikli i keqardhjes mund të jetë një ves, ti e di që po të lodh, po të rraskapit, po të harxhon dhe të vjen keq që je aty ku je, por s'po e thyen dot këtë rreth, nuk po del dot.

Ne jemi në kërkim për të ngopur etjet tona. Edhe pse zhgënjehemi, prapë vazhdojmë po në të njëjtën gjë duke i thënë vetes: "*Këtë radhë do të jetë ndryshe*", derisa zbulon që është e njëjta gjë. Është i njëjti rreth, është i njëjti zhgënjim, e njëjta ndjenjë e poshtër keqardhjeje për veten.

Ka njerëz që ngecin në këtë rreth me javë të tëra, me muaj të tërë, ka disa me vite të tëra.

Zakoni, vesi, thyhet kur së pari e pranon: “Ky ves po më kontrollon mua dhe jo unë atë.” Rreth 80% e betejës fitohet kur e pranon qe je i pafuqishëm para këtij vesi, që ky ves të ka vënë përpara dhe po të shkatërron. Nëse NUK e pranon, nuk ka për të ndodhur ndryshimi.

T'i kërkosh dikujt ndihmë nuk është e lehtë apo jo? Sidomos për ne burrat.

Në një kafe, po dilte e ëma me një djalë të vogël dhe ky çuni i vogël shkoi me vrap ta hapte ai derën. E kapi dorezën dhe e tërhiqte me sa fuqi kishte, i jepte trupit mbrapa, por nuk e hapi që nuk e hapi dot. E ëma, nuk po e ndihmonte, rrinte aty pas fëmijës dhe e linte të provonte.

Vetëm kur tha: "*O ma, nuk e hap dot!*" - vetëm atëherë e ndihmoi.

Edhe kur rritemi, prapë këtë lloj qëndrimi si ky fëmijë kemi apo jo? Jemi kokëfortë deri në fund.

"Më mirë shkatërrohemi sesa të ndryshojmë. Më mirë vdesim nga frika sesa të guxojmë të provojmë diçka të re."

Por, ndoshta me ty është ndryshe. Ndoshta sot ndjehesh sikur je lodhur duke tërhequr dorezën e një dore që nuk po hapet. Dhe do të dalësh nga cikli, nga rrethi i keqardhjes.

Kjo na sjell në Etjen e Tretë të serisë tonë:

Etje për Ndhimë.

Te **Luka 15:17-19** thuhet: “Erdhi në vete” dhe vendosi të kthehej në shtëpi dhe folëm për kuptimin e fjalës “pendesë”.

Pendesë është të kuptosh se drejtimi nga je duke shkuar po të çon shumë larg nga rruga që po përpiqesh të ecësh.

Po të çon gjithnjë e më larg Perëndisë. Pendesë nuk do të thotë vetëm të kthehesh, por do të thotë të shkosh te vendi që të takon.

Pasi djali erdhi në vete, Luka 15:20a: "*U çua, pra, dhe shkoi tek i ati.*" U kthye në shtëpi.

Për ne, pendesë do të thotë e njëjta gjë, është momenti kur vendos të kthehesh te Ati yt, te Perëndia yt.

Etja e tretë, i ndryshon të gjitha gjërat. Është momenti kur ndalon së provuari për t'i rregulluar gjërat vetë; ndalon provat për ta rregulluar vetë jetën, situatën. Në këtë moment e kupton se: "*Nuk ia dal dot vetëm.*" Ne këtë pikë lutja bëhet: "Perëndi, nëse Ti je i vërtetë, më ndihmo që të vij tek Ti për të kërkuar ndihmë."

Por përpara se të gërmojmë pak më thellë aty, le të shikojmë një herë, kur kthehemi në shtëpi, çfarë lloj Ati do të gjejmë aty? Si është ky Ati që po na pret?

Luka 15:20 "*U çua, pra, dhe shkoi tek i ati. Por kur ishte ende larg, i ati e pa dhe dhembshuri; u lëshua vrap, ra mbi qafën e tij dhe e puthi.*"

Perëndia është Ai që lëshohet me vrap drejt nesh.

Në kulturën e lindjes së mesme - *nga ku e ka kontekstin historia* - që një baba të vrapojë, ishte shumë e sikletshme para të tjerëve.

Të rinjtë vinin tek më i vjetri, ndërsa i vjetri nuk vrapon pas tyre.

Dhe aq më shumë që ky bir, ishte ai që kishte marrë gjysmën e pasurisë dhe e kishte prishur me jetë të shthurur. Në kontekstin e asaj kohe ky djalë do të kishte ngrënë një dru të mirë; 'Pse i prishe lekët? Ku i prishe lekët?'

Në kulturën kur u tha kjo histori, ky lloj fëmije do të nxirrej jashtë portave të qytetit dhe nuk do ta linin të hynte brenda në qytet, fshat. Do të merrnin enë prej balte dhe do t'i thyenin para këmbëve të tij dhe çdo person që thyente enën thoshte: "*Ti e theve, e dëmtove qytetin/fshatin tonë me sjelljen tënde. Nga ky*

moment ne të përjashtojmë nga ky vend dhe mos u kthe më kurrë këtu.”

Normalisht, kjo ishte se çfarë pritej t'i ndodhte birit që po kthehej në shtëpi, që u soll ashtu me të atin, që bëri një jetë të shthurur dhe që e prishi gjithë pasurinë e të atit. Dhe ndoshta ky djalosh këtë lloj sjellje meritonte.

Por, i ati nuk bëri asnjë nga këto gjëra siç e donte tradita. Ditë pas dite ai rrinte te veranda e shtëpisë me fytyrë nga rruga. Ka mundësi që të afërmit dhe komshinjtë do t'i kenë thënë: *“Mjaft e lodhe veten duke pritur atë mistrecin. Ai është fëmijë majmun, do t'i ketë bërë rrush e kumbulla lekët që i dhe, ndaj mos e mbaj mendjen te ai.”*

Por ai, vazhdonte çdo ditë dhe priste, shikonte nga rruga mos po vinte djali. Dhe kur e shikon nga larg, tutje në horizont, e dallon nga larg dhe niset me vrap.

Ai e poshtëron veten para komshinjve dhe të tjerëve vërdallë për ta mbrojtur djalin e tij nga tradita e vjetër.

Ai vrapoi para se ta shikonin burrat e fshatit djaloshin që po kthehej, para se t'i thonin burrat e fshatit që ti je i përjashtuar nga fshati ynë sepse me sjelljen tënde ke dëmtuar gjithë fshatin. I ati i del para, e përqafton me gjithë shpirt dhe e mbulon me puthje.

Personale për ty: "A e kupton se çfarë Ati është Perëndia? Ai është një Atë që pret, që rri e pret për ty.

Kur vjen në pikën dhe e pranon: “Unë kam nevojë për ndihmë.”, ky është reagimi i Perëndisë ndaj teje, si i këtij atit të dashur. Këtë lloj Perëndie ke për të gjetur edhe ti. Një Atë që vjen me vrap drejt teje me krahë hapur që të pranon siç je, që të mbulon me puthje, të shtrëngon me gjithë shpirt, që qan nga gëzimi.

Ideja e babit që vrapon tek i biri, më kujton historinë e atletit Derek Redmon. Në Lojrat Olimpike, Barcelonë 1992, ai ishte kandidat për të fituar garën e 400 metrave, por në 150 metra ai pati një tërheqje të fortë muskulare dhe ra në tokë dhe nuk donte ta linte garën përgjysëm; donte ta përfundonte garën. Dhe e vazhdoi garën duke çaluar pavarësisht se kishte dhimbje. Dhe në këtë moment, i ati e kalon brezin e sigurisë dhe shkon te i biri, ja ta shikojmë. **Video babait**

<https://www.youtube.com/watch?v=t2G8KVzTfwf>

Unë s'e mesova se kush e mori medaljen e artë në 400 metra në Lojrat Olimpike, Barcelonë 1992, por ama kurrë s'do ta harroj këtë moment; babai duke vrapuar tek i biri dhe duke mbaruar garën bashkë. Perëndia është Atë, Baba, që vrapon drejt teje.

Ai, është gati për të të ndihmuar ty. Ndhimja që ke nevojë quhet Jezus. Ai që po e tregon historinë e djalit të humbur, është Jezusi vetë. Arsyeja pse Ai e tregoi këtë histori është që të na ndihmojë ne që të gjejmë kollaj rrugën e kthimit te Perëndia.

Kur vjen në atë pikë të jetës tënde, kur ndjen etje të madhe, nevojë të madhe për ndihmë, do të gjesh se ndihmësi yt është Jezusi vetë, i cili është i gatshëm për të ndihmuar.

Ai është Emanuel, Perëndia me ne. Ai erdhi në tokë, jetoi 33 vjet si njeri, 100% Perëndi dhe 100% njeri. Ai kaloi çdo gjë që mund të kalojmë ne, u tundua në çdo tundim që mund të tundohemi ne, Ai vuajti që ne të shërohemi. Ai vdiq që ne të jetojmë. Ndhimja që ti ke nevojë quhet Jezus.

Përmbledhja: Kthehu në shtëpi.

Ndoshta për ty sot, është dita që do të kthehesh te Perëndia për herë të parë. Gjatë kësaj serie, ne po lutemi së bashku çdo ditë për 30 ditë dhe po vemë një bast çdo javë me Perëndinë. *“Perëndi nëse Ti je i vërtetë unë dua që të gjej, m'u shfaq mua... Ti je i vërtetë.”*

Nese po lutesh me këtë lutje çdo ditë, a po e dallon ndryshimin në jetën tënde? A po e përjeton Perëndinë këto ditë?

Ka shumë shanse që nëse je duke e kërkuar atë, Ai ka për t'u shfaqur. Ndoshta Ai të është shfaqur këtë javë, ndoshta sot, ti po e përjeton dashurinë e Perëndisë. Ndoshta për ty sonte, është Koha Për T'u Kthyer Në Shtëpi.

Ndoshta je endur gjatë nëpër lloj - lloj gjërash dhe eksperimentesh. Ke qenë në kërkim të dashurisë së vërtetë, të qëllimit të vërtetë, të kuptimit të vërtetë, po ajo që të ka ngelur në fund të ditës është një boshllëk, që s'po e mbush dot. Një dëshirë për t'ia filluar edhe një herë nga fillimi, por nuk po di sesi.

Ndoshta do të kthehesh por po heziton. Ndoshta s'të le, krenaria, s'të le sedra, që të pranosh që s'po ia del dot vetëm, të ndryshosh. Ndoshta s'të le turpi të kthehesh në shtëpi, për shkak se ke qenë në shumë vende dhe ke bërë shumë gjëra.

Ndoshta po jeton një lloj jete, si tradita e vjetër hebraike. I ke thënë vetes tënde: *“Unë nuk mund të kthehem, unë s'duhet të kthehem.”*

Unë dua ta them, më qartë sa s'bëhet më: *“Gjithmonë mund të kthehesh në shtëpi!”* Sepse Perëndia është duke parë larg, është duke kontrolluar horizontin përditë, që ti të kthehesh. Ai është një Perëndi që e mori gjithë turpin tënd, gjithë poshtërimin që të

takonte ty, e mori Ai mbi vete, sepse Ai do shumë që ti të kthehesh në shtëpi.

Nëse ti zgjedh të kthehesh në shtëpi sot, ta dish se Ai do të vrapojë drejt teje. Ai do të presë me krahë të hapur dhe kjo lloj ndihme e ka emrin Jezus.

Nëse do që t'i kërkosh ndihmë Perëndisë sot, sepse je i Etur për ndihmë, dua që sot të bëjmë diçka ndryshe.

1. Ka njerëz në këtë dhomë që nuk e kanë vendosur akoma për t'i besuar Jezusit si Zot dhe Shpëtimtar i tyre. Perëndia të është shfaqur në mënyra të ndryshme këto javë. A je gati të vendosësh për t'u kthyer në shtëpi tek Ai, tani?

Ose, ti i ke besuar Jezusit por nuk je pagëzuar akoma.

Bibla tregon sesi pagëzimi është mënyra sesi çdo person u tregon të gjithëve që ai/ajo ka vendosur të ndjekë Jezusin.

Kush ka vendosur të ndjekë Jezusin javët e fundit?

Kush ka vendosur për t'u pagëzuar, që s'është pagëzuar më parë?

(* Nëse ti do që t'i besosh Jezusit sot dhe do që të pagëzohesh por do të dish më shumë, të lutem pas festimit takohemi bashkë.)

2. Për atë që e ka marrë vendimin prej kohësh për ta ndjekur Jezusin, por ka qenë i larguar, ti e ke gjetur veten në këtë rreth pafund, cikël keqardhjeje dhe sot dot që të dalësh jashtë. Do që t'ia dorëzosh sërish veten totalisht Atij. Duke ia dorëzuar zemrën, jetën Jezusit, duke i kërkuar Atij: "Më jep një zemër të re, më bëj njeri të ri në Ty.

Kërkoji Atij të të japë një drejtim të ri. Këkoji Jezusit të të shpëtojë ty nga vetja jote.

Sot, dua t'ju nxis të hidhni një hap guximi dhe të thoni: *“Unë kam nevojë për ndihmë. Unë jam gati për t'u kthyer në shtëpi. Dua të kthehem në shtëpi.”*

Duhet kurajo për t'i thënë vetes: *“Unë kam nevojë për ndihmën e Perëndisë.”* Ti je trim, trimëreshë sepse ti do që të kthehesh në shtëpi.

Eja në shtëpi, Perëndia po të pret.

Ky është moment i bukur që na kujton sa i mirë, sa i dashur, sa i hirshëm është Perëndia.

Lutemi: ‘Dua të kthehem në shtëpi. Kam nevojë për ndihmën tënde. Dua të ri-kthehem në shtëpi. Kam nevojë për ndihmën tënde. Kam nevojë për ndihmën tënde çdo ditë, në udhëtimin tim me TY.’

Le të festojmë për njerëzit e rinj që u kthyen në shtëpi. Mos e harro gjithë javës, ti ke një Atë që rri me sy nga horizonti gjithë kohës, që shikon nga larg gjithë kohës, duke pritur që një person më shumë të kthehet në shtëpi...